

## Perjashtimet dhe lehtësimet e subjekteve të caktuara

### **Përjashtimet**

#### **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

- a) pronat e shtetit dhe të njësisve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit.”.

#### **Për tarifën e pastrimit, gjelberimit dhe ndriçimit**

përjashtohen të verbërit dhe paraplegjikët kur këta janë kryefamiljarë.

### **Lehtësirat**

Për invalidët e grupeve të tjera kanë ulje nga tarifat si më poshtë:

- a-për tarifën e pastrimit ulje në vlerë 200 lekë,
- b-për tarifën e gjelberimit dhe ndriçimit kanë ulje 100 lekë.